



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

Nr. 29 Prot.

Datë 26/04/2021

UDHËZIM

“Mbi

zhvillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese në disa njësi përbërëse të Universitetit të Tiranës”

Bazuar në nenin 6 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu II, neni 6, pika 2, germa “a”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në UT, si dhe në Urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 289, datë 04.05.2020, “Për miratimin e udhëzuesit për masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore”,

UDHËZON:

1. Votuesit pjesëmarrës (student apo personel akademik) në procesin e votimit në datë 12.05.2021 janë të detyruar të respektojnë të gjithë protokollin e masave kundër virusit SARS-CoV-2 (COVID 19).
2. Administratorët e njësive ku do të zhvillohet procesi zgjedhor, duhet të japin mbështetjen e tyre, që në mjediset ku do të ngrihen qendrat e votimit, të ketë një vend hyrje dhe një vend dalje për votuesit.
3. Në mjediset përreth Qendrave të Votimit është e ndaluar rreptësisht prezenca e materialeve të fushatës zgjedhore nga secili kandidat garues.
4. Administratori i Njesisë Kryesore dhe KZF janë përgjegjës për garantimin e standardeve zgjedhore.
5. Në mjediset e njësive kryesore gjatë ditës së zgjedhjeve është e ndaluar kategorikisht fushata në mbështetje të kandidatëve garues. Personeli i administrimit në njësitë kryesore të UT, duhet të marrë masat e nevojshme, në komunikim me KZF e njësisë ku po zhvillohet procesi i votimit.

6. Qendra e votimit hapet në orën 8:00 dhe mbyllet zyrtarisht në orën 16.00. Nëse pas orës 16.00 ka ende votues në radhë, mblidhen mjetet e tyre të identifikimit dhe procesi përfundon pasi edhe këta të fundit, të kenë votuar.
7. Votuesit duhet të respektojnë gjithë rregullat e protokollit Anticovid të institucionit, që në hyrje të tij për matjen e temperaturës si edhe të jenë të pajisur me maska.
8. Votuesit ndjekin sinjalistikën për t'u drejtuar në qendrën e tyre të votimit, respektojnë radhën jashtë qendrës së votimit, duke respektuar distancimin social sipas sinjalistikës së vendosur në mjediset universitare, sikurse dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen nga një anëtar i komisionit të QV.
9. Në Qendrën e Votimit është i ndaluar kategorikisht përdorimi i celularit si nga votuesit ashtu edhe nga anëtarët e komisioneve zgjedhore me përjashtim të KZF-së apo anëtarit të ngarkuar nga KZF-ja, si kordinator me KIZ.
10. Votuesit e trupës zgjedhore të kategorisë “student”, paraqiten para KQV duke u identifikuar, programin ku bën pjesë dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit, si Kartë Identiteti, Pasaportë ose Kartë Studenti.
11. Kryetari i KQV-së, verifikon se të dhënat e identitetit të votuesit, përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se votuesi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, (i kërkohet të ulë maskën për identifikim duke respektuar distancimin nga tavolina e Komisionit). Kryetari shënon në listën e zgjedhësve, llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe më pas i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë.
12. Studenti, që është i pajisur nga një Vendim të KIZ për të votuar, pasi hyn në QV e paraqet atë tek kryetari i komisionit në atë Qendër Votimi. Emri i këtij zgjedhësi dhe numri i kartës së identitetit të tij shënohet në Fletoren e Protokollit të Ditës së Votimit, që më pas futet në Kutinë e Materialeve dhe Dokumenteve të Votimit për dorëzim në KIZ.
13. Votuesi nënshkruan në listen e zgjedhësve përbri emrit të tij.
14. Votuesit e trupës zgjedhore të kategorisë “student” në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Filialin e Sarandës, i jepet për të votuar fleta e votimit:
 - i. për drejtues të njësisë kryesore
15. Votuesit e trupës zgjedhore të kategorisë “personel akademik” në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Filialin e Sarandës, i jepet për të votuar fleta e votimit:
 - i. për drejtues të njësisë kryesore;
16. Votuesit e trupës zgjedhore të kategorisë “personel akademik” në Departamentin e Matematikës së Aplikuar në FSHN dhe Departamentin e Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Rrjetet e Monitorimit në IFBZ, i jepet për të votuar fleta e votimit:
 - i. për drejtues të njësisë bazë në të cilën bëjnë pjesë;
17. Çdo fletë votimi është e vulosur, në pjesën e pasme të saj, me vulën e KZF-së dhe KQV-së kur ka të tilla.
18. Pasi merr fletët e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë:
 - i. në fletën e votimit për drejtues të njësisë kryesore/njësisë bazë shënon në krah të emrit të kandidatit shenjën "+" ose "x" ose "√". Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri. Në rastin kur për autoritet drejtues konkuron vetëm një kandidat, zgjedhësi voton duke

- shënuar shenjat e mësipërme në një nga alternativat e shkruajtura krahas emrit të kandidatit "Pro" ose "Kundër";
- ii. pasi bën shënimin e tij në fletën e votimit, ai i palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme por duhet të jenë të dukshme vula/vulat e KZF-së dhe KQV-së (kur ka të tillë), del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët në kutinë e votimit.
19. Votuesi është i detyruar të hyjë në dhomën e fshehtë për të votuar, pëmdryshe nuk lejohet të fusë fletët e votimit në kuti.
20. Në qendrën e votimit ndalohet kategorisht përdorimi i aparateve celulare apo i mjeteve të tjera regjistruese. Votuesi duhet të hyjë në dhomën e fshehtë i pangarkuar me çanta, mjete apo sende, qoftë edhe shkollore.
21. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të votimit lejohen të qëndrojnë vetëm:
- anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së;
 - zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre;
 - vëzhguesit e akredituar nga KIZ;
22. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të numërimit të votave lejohen të qëndrojnë vetëm:
- anëtarët dhe sekretari i KZF;
 - kandidatët garues;
 - vëzhguesit e akredituar nga KIZ.
23. Kryetari i KZF në rast të shkeljes së rregullit dhe qetësisë nga pjesëmarrësit e lejuar në të gjatë numërimit, ndërpret procesin e numërimit, bën mbledhjen urgjente të KZF dhe merr vendimin përkatës për personin që cenon respektimin e standardeve zgjedhore. Për vendimin komunikon me KIZ dhe ky i fundit komunikon me Administratorin e UT, për marrjen e masave për sigurinë dhe rendin në institucion.
24. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | |
|---------------------|-----------|
| 1. Edvin Lame | (Kryetar) |
| 2. Xhensila Kadi | (Anëtare) |
| 3. Alnida Koroshi | - // - |
| 4. Shaniko Allajbeu | - // - |
| 5. Arjan Tushaj | - // - |
| 6. Eljon Doçe | - // - |
| 7. Dhurata Saraçi | - // - |

